



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1527/2 Prot.

Tiranë, më 19 / 11 / 2018

V E N D I M

Nr. 234 , Datë 19 / 11 / 2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 170, datë 01.11.2018, të paraqitur nga shtetasi K.N kundër Dekanit të Fakultetit Ekonomik në Universitetin “Fan Noli” Korçë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë”. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga K.N, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë, në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash deklaroi se, që prej muajit Shkurt 1995 është i punësuar pranë Universitetit të Korçës në detyrën si pedagog në Fakultetin Ekonomik. Ankuesi shprehet se ndihet i fyer dhe diskriminuar nga sjellja e papërgjegjshme, abuzive dhe e kundërligjshme e Dekanit të Fakultetit Ekonomik për faktet si më poshtë:

- Prej periudhës Qershor 2017, Dekani nuk firmos në listëprezencën mujore që lidhet me pagën, emrin e ankuesit. Listëprezenca firmoset nga Rektori i Universitetit.
- Prej periudhës Shtator 2017, ankuesi nuk lejohet për të ushtruar të drejtën për të qenë anëtar në komisionet e provimit të diplomimit të studentëve, megjithëse është titullar në dy prej lëndëve më të rëndësishme të formimit profesional.
- Në muajin Tetor 2018, në shkelje flagrante me ligjin, duke shpërdoruar dhe abuzuar me detyrën, dhe duke manipuluar me qëllim listën e zgjedhësve, i ka hequr ankuesit të drejtën për të votuar në zgjedhjet e pjesshme të zhvilluara në Fakultetin Ekonomik për zgjedhje e një anëtar të senatit.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

Ankesa e sjellë pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me shpjegimet e dhëna prej subjektit ankues, në lidhje me shkakun e pretenduar dhe lidhjes shkakësore për trajtimin më pak të favorshëm.

- Për këtë arsye, me e-mail-in datë 06.11.2018, inspektori i çështjes, i ka kërkuar ankuesit të paraqesë shpjegime lidhur me shkakun e pretenduar (përkatësia në një grup të veçantë) dhe shpjegime të trajtimit të pabarabartë në raport me pedagogët e tjerë për shkakun e pretenduar.
- Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, ankuesi me e-mail-et datë 06.11.2018 dhe 11.09.2018 ka dërguar kopje të ankesave drejtuar autoriteteve drejtuese të Universitetit të Korçës si dhe ka informuar Komisionerin si më poshtë: *“Në komisionet e diplomimit të periudhës Korrik-Shtator 2018 kanë marrë pjesë të gjithë pedagogët e universitetit me përjashtim të emrit të tij. Ndërsa në lidhje me shkakun e diskriminimit nuk e di arsyen e vërtetë por mendon se ka lidhje me procesin zgjedhor të zhvilluar para 6 viteve në të cilin ankuesi nuk ka votuar për postin e dekanit”*.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstronhet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur. Ankuesi në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, lidhur me shkakun e diskriminimit.

Ankuesi lidhur me shkakun e pretendimit për diskriminim shprehet se: *“Arsyeja mund të jetë pasi para 6 vitesh nuk e ka votuar për pozicionin e dekanit të Fakultetit Ekonomik¹”*.

Në lidhje me këtë, Komisioneri vlerëson se nuk e gjen të bazuar në ligj si një nga shkaqet e parashikuara në nenin 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Përkundrazi, marrja pjesë dhe angazhimi për të zgjedhur organet drejtuese të IALP-ve është një detyrim qytetar i çdo punonjësi të administratës shtetërore, në zbatim të detyrave funksionale të tyre.

Ankuesi në rastin në fjalë, ka paraqitur informacion lidhur me konfliktin dhe problematikën që ka me Dekanin e Fakultetit Ekonomik, por nuk ka paraqitur fakte dhe prova apo shpjegime për të provuar shkakun e diskriminimit të pretenduar dhe për të provuar se heqja e emrit të ankuesit nga lista e pedagogëve, për të votuar në zgjedhjet e pjesshme të zhvilluara në Fakultetin Ekonomik është bërë për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë” apo cilësive të veçanta që ankuesi ka.

Për sa më sipër, Komisioneri vëren se, shtetasi K.N mund të jetë vënë përpara veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme të Dekanit të Fakultetit Ekonomik, por në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkaqeve të pretenduara nga ankuesi, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/b të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se *“Ankesa nuk pranohet nëse është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/b dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së shtetasit K.N, për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

¹ Referuar e-mail-it të dërguar nga subjekti ankues në datë 06.11.2018, ora 06:16 PM.